

Terma reference

Thirrje për Konsulencë (ekspert /grup ekspertësh)

Konsulenca	Ekspert për mbështetjen e Ministrisë së Brendshme për të vlerësuar nevojën dhe modalitetin për ngritjen e një strehe të specializuar për të mbijetuarit e trafikimit në veri të vendit
Projekti	“Përgjigje ndaj rrezikut të shtuar të abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe ndarjes nga familja” zbatuar në partneritet me UNICEF (ALB/PCA202213/PD202359)
Zonat e projektit	Rajonet Tiranë, Shkodër, Durrës dhe Kukës (Disa shërbime specifike mbulojnë gjithë territorin e Shqipërisë
Kohëzgjatja e shërbimit	10 Prill – 31 Qershor 2023
Lloji i kontratës	Kontratë Shërbimi
Data e fillimit të punës	05 Maj 2023

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të kontraktojë **një ekspert lider, dy ekspertë kombëtarë** për mbështetjen e Ministrisë së Brendshme për të vlerësuar nevojën dhe modalitetin për ngritjen e një strehe të specializuar për të mbijetuarit e trafikimit në veri të vendit, **një ekspert inxhinier** për vlerësimin e infrastrukturës dhe **një ekspert për kostimin e shërbimit**, si pjesë e programit “Përgjigje ndaj rrezikut të shtuar të abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe ndarjes nga familja” zbatuar nga Nisma ARSIS në partneritet me UNICEF.

Rreth Nisma ARSIS

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimisht Nisma) është një organizatë jofitimprurëse e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. Nisma është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i Nisma është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupet më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane. Nisma advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbimit ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabel.

Rreth projektit

Output 1: Fëmijëve dhe prindërve/kujdestarëve të tyre në situata me rrezik të lartë të prekur/eksponuar ndaj dhunës dhe në nevojë për mbrojtje u ofrohen shërbime të reagimit emergjent dhe strehë 24/7 dhe sistemi ekzistues kombëtar i mbrojtjes së fëmijëve është i aftësuar.

Output 2: Mbështetje për agjencitë e zbatimit të ligjit për të zbatuar masat për mbrojtjen e fëmijëve përmes punës së lëvizshme në terren.

Output 3: Procesi i deinstitutionalizimit në Shqipëri është avancuar nëpërmjet ngritjes së dy

shërbimeve të reja pilot për fuqizimin e fëmijës dhe familjes përfshirë dhe kujdesin alternativ (SHMFF) në nivel Bashkie dhe mbështetjes teknike për ASHDMF, SHSSH dhe MSHMS.

Output 4: Mbështetja e Ministrisë së Brendshme për të vlerësuar nevojën dhe modalitetin për një strehë të specializuar për të mbijetuarit e trafikimit dhe profilizimin e bashkive, hartëzimi i partnerëve dhe shërbimeve në Shqipëri.

Qëllimi i ekspertizës

Qëllimi i ekspertizës është të vlerësojë nevojën dhe modalitetin për ngritjen e një strehe të specializuar për të mbijetuarit e trafikimit në veri të vendit.

Në kuadër të këtij qëllimi, eksperti lider dhe grupi i ekspertëve duhet të:

- Hartojnë metodologjinë dhe instrumentat specifikë që përfshijnë vlerësimin e nevojave dhe modaliteteve për ngritjen e një strehe të specializuar për të mbijetuarit e trafikimit në veri të vendit;
- Zhvillimin e takimeve individuale me përfaqësues të pushtetit lokal për të identifikuar nevojat dhe mundësitë për ngritjen e shërbimit;
- Përcaktojnë kalendarin për periudhën e zhvillimit të vlerësimit, përcaktimit të skenarëve të mundshëm (modalitetin) dhe përgatitjes së raportit.

Metodologjia për përgatitjen e vlerësimit të nevojës dhe modalitetin duhet të konsiderojë:

- Vlerësimin e nevojës dhe modalitetin bazuar në kapacitetet e pushtetit lokal për të ngritur një shërbim strehe, burimet financiare, infrastrukturën dhe burimet njerëzore.
- Përgatitjen e skenarëve të mundshëm për ngritjen e shërbimit në përputhje me nevojat e pushtetit lokal.

Detyrat

Lot 1: Ekspert lider (15 ditë pune)

Si pjesë e kësaj ekspertize, Eksperti duhet të realizojë:

- Të përgatisë një outline të vlerësimit (të nevojës dhe modalitetit), i cili përmban dimensionet e vlerësimit të nevojave dhe mundësive duke konsideruar angazhimin e një ekipi prej 4 ekspertësh (kombëtarë, të kostimit dhe inxhinier). Ky outline duhet të dakordësohet me ekspertët pjesë të ekipit, NISMA dhe UNICEF;
- Të përgatisë instrumentat për mbledhjen dhe analizën/prezantimin e informacionit në nivel vendor dhe të përgatisë ekspertët kombëtarë për procesin e mbledhjes së të dhënave (me aktorët vendor);
- Të kryejë një shqyrtim të materialeve, studimeve, apo dokumenteve ligjore për të dhënat, shërbimet ekzistuese në bashki të tjera që do të vijin në ndihmë hartimit të skenarëve/modalitetit të ngritjes një strehe të specializuar për të mbijetuarit e trafikimit në veri të vendit;
- Të ndjekë nga afër mbledhjen e të dhënave në terren;
- Të kryejë analizën tematike të të dhënave;
- Të integrojë të dhënat e mbledhura nga të gjithë ekspertët për të përgatitur raportin final dhe skenarët e mundshëm;
- Të përgatisë një raport paraprak që do t'u paraqitet palëve të interesuara (që do të identifikohet nga eksperti);
- Të prezantojë rezultatet tek palët përkatëse të interesit në takimet konsultative;

- Të sigurojë që komentet/sugjerimet përkatëse që rrjedhin nga procesi i konsultimit të përfshihen në versionin përfundimtar të raportit.

Lot 2: Ekspert kombëtare (2)

2.1 Ekspert kombëtar (50 ditë pune)

Si pjesë e kësaj ekspertize, Eksperti duhet të realizojë:

- Të kryejë një shqyrtim të materialeve, studimeve, apo dokumenteve ligjore dhe të brendshme të bashkisë së targetuar për të vlerësuar nevojën dhe modalitetin e ngritjes së një shërbimi të ri;
- Të kryejë mbledhjen e të dhënave në terren përmes mjeteve sasiore dhe cilësore dhe të kryejë një analizë tematike të të dhënave (takime individuale dhe plotësimin e pyetësorëve dhe mbledhjen e të dhënave nga bashkia);
- Të bashkëpunojë në ekip për hartimin e vlerësimit;
- Të prezantojë në formë statistikore dhe narrative potencialin e bashkisë në disa drejtime për ngritjen e shërbimit duke parashikuar ngritjen e disa skenarëve potencial për ngritjen e shërbimit të strehës;
- Të përgatisë një raport specifik për bashkinë paraprak që do t'u paraqitet palëve të interesuara;
- Të sigurojë që komentet/sugjerimet përkatëse që rrjedhin nga procesi i konsultimit të përfshihen në versionin përfundimtar të raportit;
- Të përgatisë një listë të përditësimeve të bëra në raport për të lehtësuar ndjekjen nga UNICEF.

Lot 3: Ekspert inxhinier (10 ditë pune)

Si pjesë e kësaj ekspertize, Eksperti duhet të realizojë:

- Të vlerësojë infrastrukturën fizike të targetuar nga bashkia për ngritjen e strehës;
- Të kryejë një analizë të thelluar të situatës aktuale të terrenit ku do të ndërtohet/ apo të objektit që do të rikonstruktohet/riparohet në bashkinë e targetuar për ngritjen e strehës;
- Të përgatisë dizajnin konceptual siç do të përshkruhet nga ekspertët (minimalisht dy opsione për vendodhjen e përcaktuar);
- Të përgatisë një plan të thjeshtë për ngritjen e strehës;
- Të përgatisë një raport përmbledhës mbi opsionet/skenarët e parashikuar në ekip për të ngritjen e një strehe të specializuar për të mbijetuarit e trafikimit në veri të vendit.

Lot 4: Ekspert për kostimin e shërbimit (7 ditë pune)

Si pjesë e kësaj ekspertize, Eksperti duhet të realizojë:

- Të organizojë ditët e punës në bashkëpunim me ekipin e NISMA sipas kalendarit të dakordësuar
- Të hartojë metodologjinë e punës dhe planit të punës për realizimin e ekspertizës në mënyrë efektive dhe cilësore
- Të ndjekë takimet konsultuese në nivel vendor dhe me UNICEF
- Të propozojë skenarë për kostimin e shërbimeve që do të ofrohen në përputhje me modalitetet e propozuara në ekip nga ekspertët në bashkëpunim me bashkinë e targetuar.
- Të ofrojë asistencë për Bashkinë (target të projektit) për përgatitjen e formateve financiare për buxhetimin e shërbimeve të nevojshme për ngritjen e strehëzës

Eksperi lider dhe ekspertët duhet të dorëzojnë:

Lot 1: Ekspert lider

- 1.1 Metodologjia e vlerësimit e dakordësuar në ekip;
- 1.2 Raport përshkrues i vlerësimit të nevojës dhe mundësive për ngritjen e strehës të specializuar për të mbijetuarit e trafikimit në veri të vendit;
- 1.3 Takim konsultues me UNICEF

Lot 2: Ekspertë kombëtarë

- 2.1 Planifikimi i kalendarit të veprimtarive për realizimin e vlerësimit në bashkinë e targetuar;
- 2.2 Raport përshkrues i procesit dhe i analizës së kapaciteteve të bashkisë dhe burimeve njerëzore profesionale për administrimin e shërbimeve, skenarëve dhe mundësive për ngritjen e shërbimit;

Lot 3: Ekspert inxhinier (10 ditë pune)

- 3.1 Metodologjia e vlerësimit të infrastrukturës dhe kalendarit të takimeve për vlerësimin në terren;
- 3.2 Raport përshkrues mbi dizenjimin dhe ndërhyrjet e nevojshme për infrastrukturën për ngritjen e strehës së specializuar;

Lot 4: Ekspert për kostimin e shërbimit (7 ditë pune)

- 4.1 Raport që përfshin kostimin e shërbimit të strehës së specializuar sipas skenarëve/modalitetit të propozuar në ekip nga ekspertët në bashkëpunim me bashkinë e targetuar.

Shënim: Eksperti lider dhe ekspertët duhet të jenë të gatshëm për lëvizje në bashkinë e targetuar nga projekti.

Afatet kohore

Aktivitete	Afati
Dorëzim i Metodologjisë	05 Maj 2023
Analiza dhe Mbledhja e të dhënave	10 Maj – 25 Maj 2023
Raporti i parë draft	05 Qershor 2023
Raporti përfundimtar i konsultuar	15 Qershor 2023

Kualifikime dhe eksperiencia e punës:

- Diplomë universitare e ndërthurur me trajnime të specializuara në fushën e shkencave sociale dhe shkencave respektive sipas profilit të kërkuar (Inxhinieri dhe Financë).
- Njohuri shumë të mira dhe eksperiencë të mëparshme në hartimin e metodologjive, udhëzuesve, analizave dhe vlerësimeve të shërbimeve shoqërore.
- Njohuri shumë të mira të paketës ligjore të shërbimeve shoqërore dhe të funksionimit të pushtetit vendor.
- Njohuri shumë të mira të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2020-2023 dhe të gjithë paketës ligjore për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror me fokus shërbimet residenciale.
- Më tepër se 10 vite eksperiencë profesionale si ekspert, dhe praktikë në sistemin e mbrojtjes sociale dhe shërbimeve shoqërore;

- Përvojë me koordinimin e veprimeve për realizimin e raporteve, manualeve dhe analizave në fushën e mbrojtjes sociale.

Politikat e Mbrojtjes: Të gjithë personat që punojnë me programet e NISMA janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, kodin e sjelljes bashkëngjitur me termat e referencës.

Koha e e mundshme e fillimit të punës është 01 Maj 2023.

Kjo ekspertizë përfshin 15 ditë punë për ekspertin lider, 50 dite pune në total për 2 ekspertët kombëtarë, 10 ditë pune për ekspertin inxhinier, dhe 7 ditë pune për ekspertin e kostimit.

Procedura e Aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e ekspertit duhet të dërgojnë me email:

- 1- Shprehje interesi
- 2- Curriculum Vitae (evidence të punëve të mëparshme të ngjashme);
- 3- Draft të parë të metodologjisë së propozuar bashkë me planin e punës;
- 4- Oferta financiare (të gjitha taksat përfshirë)
- 5- Taksa e rregjistrimit (nëse disponohet)
- 6- Deklaratë e disponueshmërisë dhe angazhimit për të ndërmarrë dhe përfunduar shërbimet në kuadër të kësaj konsulence brenda afateve kohore

Gjithë dokumentacioni i aplikimit duhet të dorëzohet në adresën e emailit:

initiative.arsis@gmail.com ose të dorëzohet aplikimi me postë ose dorazi pranë zyrave të Nisma ARSIS në adresën: Rr. Sali Butka, Pallati T.B.M, Ap.1, Kodi postar 1023, në një zarf të mbyllur deri në datën 27 Prill 2023, ora 16.00 me subjekt: Aplikimi për **“Ekspert për mbështetjen e Ministrisë së Brendshme për të vlerësuar nevojën dhe modalitetin për ngritjen e një strehe të specializuar për të mbijetuarit e trafikimit në veri të vendit” (duke specifikuar nr e Lot dhe llojin e ekspertizës)**

Procedura e Vlerësimit

Përzgjedhja e ekspertit/grupit të ekspertëve do të bazohet në treguesit e paraqitur në tabelën e vlerësimit si më poshtë.

Kriteret e vlerësimit	Vlerat në %
Kualifikime	20%
Eksperiencë pune	50%
Oferta financiare	30%

Vetëm kandidatët e përzgjedhur për pozicionin e Ekspertit/es/grup ekspertësh do të kontaktohen.